






KANS

KOSOVO ■ AIR
NAVIGATION ■
■ SERVICES

Titulli: PL-INTG-001
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 1 nga 16

REPUBLIKA E KOSOVES AGENCIA E SHERBIMEVE TE NAVIGACIONIT AJRORE RIPUBLICA KOSOVA AGENCIA ZA VARNOSTNO NAVIGACIJSKE USLUGE REPUBLIC OF KOSOVA AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E KRYESORE KANCELARIA E PRIME PRINCIPAL OFFICE	
№. prot. Prot. no.	16
№. prot. Prot. no.	1013
Data Date	17.12.25
F.M. LIPJAN RKS	

PLANI I INTEGRITETIT TË KANS

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Ilir Dukolli	Petrit Murtezaj	Samir Bllacaku
Datë	17.12.2025	17-12-2025	17.12.2025
Nënshkrimi			

Ky dokument është pronë e:

Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror 10070 Vrellë, Lipjan
Republika e Kosovës

Prona intelektuale e Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror) mbrohet në bazë të Ligjit Nr. 08/L-205 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Çdo kopjim ose riprodhim i këtij materiali pa leje me shkrim të publikuesit, është i ndaluar.

Samir Bllacaku

Drejtor i Përgjithshëm

**KANS**KOSOVO ■ AIR
NAVIGATION ■
■ SERVICESTitulli: PL-INTG-001
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 3 nga 16**1. LISTA E SHPËRNDARJES**

Kopja	Vendndodhja	Forma	Copë
1	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (SMD) i Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror	Elektronike	1
2.	Ueb Faqe	Elektronike	1
3.	Menaxherët e Departamenteve	Elektronike	1
4.	Arkivi i Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror	E shtypur	1



KANS

KOSOVO AIR
NAVIGATION
SERVICES

Titulli: PL-INTG-001
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 4 nga 16

2. PËRMBAJTJA

1. LISTA E SHPËRNDARJES	3
2. PËRMBAJTJA	4
3. DEKLARATA E INTEGRITETIT	5
4. HYRJE	6
5. QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITET	7
6. OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT	7
7. PROCESI I PËRDITËSIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT	8
8. PROCESI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT NË INSTITUCION	9
9. MONITORIMIT I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI	10
10. FUSHAT E RREZIKUT	11
Fushat e përgjithshme të Rrezikut	11
Fushat specifike të rrezikut	11
11. PYETËSORI	11

3. DEKLARATA E INTEGRITETIT

Kjo deklaratë ka për qëllim pasqyrimin e politikave, procedurave dhe masave tjera në lidhje me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien në Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Deklarata mbështetet në Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin Nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe “Metodologjia e Planit të Integritetit”, përgatitur nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Me plan të integritetit, synohet zbatimi sistematik dhe gjithëpërfshirës i standardeve, parimeve dhe objektivave në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera që cenojnë integritetin e institucionit.

Me identifikimin e rreziqeve në Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si dhe planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, mundësohet forcimi i sundimit të ligjit, forcohet integriteti, ngritet besimi i palëve të interesit në shërbimet tona, si dhe eliminohen shkaqet e korrupsionit.

Ne besojmë që ky Plan i Integritetit do të ndihmojë në parandalimin e veprimeve korruptive dhe zotohemi për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit në Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Samir Bllacaku

Drejtor i përgjithshëm



KANS
KOSOVO ■ AIR
NAVIGATION ■
■ SERVICES

Titulli: PL-INTG-001
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 6 nga 16

4. HYRJE

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me "Metodologjinë e Planit të Integritetit", Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror (tutje - KANS) përditëson Planin e Integritetit për vitin 2026.

Plani i Integritetit është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda institucionit dhe ofron masa për menaxhimin e integritetit, për të arritur objektivat e integritetit në KANS.

Plani rritet përkushtimin e KANS për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të KANS.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Plani i Integritetit mund të ndryshohet, në përputhje me nevojat, zhvillimin dhe interesin e institucionit. Rishikimi i Planit të Integritetit bëhet çdo vit, duke marrë në konsideratë rezultatet e zbatimit të masave të propozuara për reduktimin e rrezikut, me ç'rast masat që rezultuan në mënyrë të pamjaftueshme, zëvendësohen me masa të reja.

5. QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani për Integritet është dokument i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit në KANS. Ky plan synon përmirësimin dhe promovimin e vetëdijes institucionale, përkatësisht zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe standardeve profesionale gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nga punonjësit e KANS.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve që ekspozojnë institucionin ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit;
- Vlerësimin e rreziqeve të identifikuar dhe ndikimi i tyre në shfaqjen e korrupsionit;
- Evidentimin e masave ekzistuese dhe përcaktimin e masave parandaluese ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo profesionale.

6. OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivi kryesor i këtij Plani të Integritetit është standardizimi i procedurave dhe praktikave të brendshme të funksionimit të KANS, në mënyrë që të parandalohen rreziqet që mund të çojnë në veprime korruptive, duke krijuar një sistem efektiv për menaxhimin e integritetit në institucion.

Objektivi tjetër i këtij plani është shmangia nga situatat e konfliktit të interesit në proceset e punës në KANS, që rrjedhimisht konsiderohet zbatim i detyrave dhe përgjegjësi, bazuar në parimet e integritetit. Në këtë aspekt, përmes veprimeve konkrete, KANS do të sigurohet që të gjithë zyrtarët janë të vetëdijshëm me situatat e konfliktit të interesit.

Mungesa e monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies në punë ndikon në cënueshmërinë e integritetit, prandaj KANS duke vendosur masa përkatëse, do të sigurojë zbatimin e proceseve transparente dhe llogaridhënese, me theks të veçantë në fushat që lidhen me burimet njerëzore dhe menaxhimin e financave.

Krijimi i një sistemi më efikas të kontrollit të brendshëm konsiderohet ndër faktorët kryesor për të avancuar performancën e integritetit. Për të realizuar këtë objektiv, KANS do të identifikojë mangësitë eventuale në këtë fushë dhe do të propozoj masa, përkatësisht veprime korrigjuese të nevojshme, që ndikojnë në efikasitetin e kontrollit të brendshëm.



7. PROCESI I PËRDITËSIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i përditësimit të Planit të Integritetit të KANS zhvillohet sipas fazave në vijim:

Faza e parë: Drejtori i Përgjithshëm i KANS përmes vendimit Nr. 167/25 të datës 24.09.2025 ka caktuar grupin punues për përditësimin e Planit të Integritetit të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Faza e dytë: Grupi punues ka krijuar pyetësin elektronik për identifikimin e rreziqeve, i cili është adresuar te personeli i KANS përmes e-mailit. Bazuar në përgjigjet e personelit, janë përditësuar rreziqet që mund të ndikojnë në cënueshmërinë e integritetit.

Faza e tretë: Grupi punues përmes të dhënave të siguruara nga shqyrtimi i dokumenteve dhe rezultatet e pyetësit, ka përpiluar një listë gjithëpërfshirëse të rreziqeve që mund të cenojnë veprimtarinë e institucionit. Përmes matricës së vlerësimit të rrezikut, përkatësisht rezultatit të fituar nga probabiliteti i shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit, grupi punues ka identifikuar dhe propozuar masat përkatëse parandaluese. Drafti i përgatitur i Planit të përditësuar është dërguar për komentim në APK dhe pas pranimit të komenteve është adresuar për miratim nga ana e Drejtorit të KANS dhe për publikim në uebfaqe të ASHNA/KANS.

**KANS**KOSOVO • AIR
NAVIGATION
SERVICES

Titulli: PL-INTG-001

Versioni: 1.0

Klasifikimi: Brendshëm

Faqe: 9 nga 16

8. PROCESI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT NË INSTITUCION

Grupi punues të dhënat e shqyrtuara i ka trajtuar përmes tabelave në vijim:

1. Matrica e vlerësimit të rrezikut
2. Niveli i rrezikut dhe
3. Lista e rreziqeve.

Pasoja /Ndikimi	Mëdhor	10																	
		9																	
		8																	
	Mesatar	7																	
		6																	
		5																	
		4																	
	Vogël	3																	
		2																	
		1																	
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar							Lartë							
		Probabiliteti/Gjasat																	

Tabela 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", i paraqitur në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme dhe përshkrimet vijuese:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 – 48	49 – 100

Tabela 2 Niveli i rrezikut

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.



KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION
SERVICES

Titulli: PL-INTG-001

Versioni: 1.0

Klasifikimi: Brendshëm

Faqe: 10 nga 16

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

9. MONITORIMIT I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit-APK ka mandatin ligjor për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit, ndërsa përmes kontrollit të drejtpërdrejtë në KANS, mund të zhvillojë procedurën e hetimit administrativ të raportit. APK për zbatimin e Planit të Integritetit mund të nxjerrë opinione/rekomandime për parandalimin e korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit.

Grupi punues, pas marrjes së pëlqimit nga APK, Planin e përditësuar të Integritetit e dërgon për nënshkrim te Drejtori i Përgjithshëm i KANS. Vendimi për miratim dhe Plani i Integritetit i përditësuar i dorëzohet Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e miratimit.

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi edhe nga zyrtari përgjegjës i KANS, për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë duke u zbatuar dhe janë efektive në avancimin e performancës së integritetit.

Personi përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit, i raporton Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, çdo gjashtë (6) muaj, ku përfshihen evidenca të sakta mbi zbatimin e masave të propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve.

Zyrtari përgjegjës i KANS obligohet të përgatis dhe të paraqesë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit raportin vjetor për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin paraprak më së largu deri më 31 janar të vitit vijues.



10. FUSHAT E RREZIKUT

Bazuar në metodologjinë e hartimit të këtij dokumenti, rreziku që ndikon në integritetin e KANS, kategorizohet në dy kategori: fushat e përgjithshme të rrezikut dhe në fushat specifike të rrezikut.

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Menaxhimi financiar,
- Prokurimi publik dhe Menaxhimi i projekteve/kontratave
- Kontrolli i brendshëm (auditimi) dhe mekanizmat kundër korrupsionit;
- Siguria e teknologjisë së informacionit.

Fushat specifike të rrezikut

- Ruajtja dhe siguria e të dhënave/ dokumenteve që lidhen me sigurinë e ofrimit të shërbimeve.

Renditja e rreziqeve të integritetit të identifikuara në fushat e përmendura më sipër është bërë duke filluar nga rreziqet me nivel të lartë, të cilat kanë ndikim thelbësor në integritetin e institucionit dhe që mund të rrezikojnë efektshmërinë dhe reputacionin e tij. Gjithashtu, janë paraqitur edhe rreziqet me nivel të ulët, të cilat mund të mos kërkojnë masa të menjëhershme, por vetëm monitorim të vazhdueshëm.

11. PYETËSORI

Ne kuadër të përditësimit të Planit të Integritetit, KANS ka krijuar pyetësorin i cili është realizuar përmes e-mailit.

Të dhënat nga dokumentet e shqyrtuara dhe rezultateve të pranuara nga pyetësori, sipas fushave përkatëse të rrezikut, grupi punues i ka pasqyruar në formë tabelare, si në tabelen Nr.3.

Rreziqet gjithashtu janë vlerësuar bazuar në kriteret e matricës dhe janë propozuar masat përkatëse parandaluese të cenimit të integritetit, duke përfshirë edhe afatet dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre.

LISTA E RREZIQEVE

Planit i Integritetit									
Fushat e përgjithshme të rrezikut									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	Mungesa e njoftimit të stafit me rregulloret, udhëzimet dhe procedurat pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri 08/L-305 për KANS.	Manuali i Menaxhimit të Cilësisë – Procedura PC-001 për Kontrollin e dokumenteve	3	8	24	Menaxherët e departamenteve sigurohen që stafi janë njoftuar me aktet e brendshme.	ISO Ekipi; Menaxherët e Departamenteve	30.06.2026	
	Mungesa e njohurive të stafit për mundësinë e ankimit pas ndryshimeve në legjislacion.	Ligji Nr. 08/L-305 për KANS; Ligji Nr. 03/L-212 I Punës; Rregullore për Marrëdhënien e Punës së Personelit të KANS	3	6	18	Monitorimi i respektimit të Procedurës PC-001 për Kontrollin e dokumenteve (përmasa auditeve të cilësisë)	ISO Ekipi; Menaxhmenti i KANS-së	30.06.2026	



KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION
SERVICES

Menaxhimi financiar	Mungesa e vlerësimit të drejtë të ndarjeve buxhetore, duke krijuar hapësirë për favorizime, presion, konflikt interesi dhe vendime të bazuara në analizë jo reale.	Ligji Nr. 08/L-305 për KANS; Plani 5 vjeçar i Biznesit; Aktet e brendshme financiare të KANS	4	8	32	a) Në planifikim të buxhetit të përfshihet staf profesional dhe ndarjet buxhetore të jenë në pajtim me Planin afatgjatë të biznesit; b) Përdorimi i kriterëve të qarta dhe të dokumentuara për vlerësimin e nevojave dhe projekteve (kosto-përfitimi, ndikimi operativ, urgjenca, përputhja me objektivat strategjike). c) Rritja e transparencës, përmes dokumentimit të qartë të arsyetimeve për çdo vendim buxhetor dhe publikimit të kriterëve të priorizimit.	ZKF; Menaxheri i DFIN	31.10.2026
	Mungesa e ndarjes së detyrave përgjatë ekzekutimit të pagesave	Rregullore për Menaxhimin e Financave në KANS; Procedura për ekzekutimin e buxhetit në KANS;	3	8	24	Monitorimi i respektimit të Procedurës së ekzekutimit të buxhetit.	ZKF; Menaxheri i DFIN; Udhëheqësit e Divizioneve në DFIN	30.06.2026

Prokurimi publik	Favorizimi i operatorëve ekonomikë përmes përgatitjes së specifikimeve teknike të njëanshme.	Ligji për Prokurimin Publik; Udhëzuesi Nr.001 për prokurimin publik;	6	9	56	a)Përcaktimi i kërkesave teknike duhet të bazohet në funksion, performancë dhe nevojën reale të organizatës; b)Referim ndaj standardeve si ISO, EN, IEC , etj., në vend të markave ose modeleve specifike; c)Organizimi i trajnimeve për stafin përkatës në fushën e përgatitjes së specifikave teknike.	Njësit kërkuese; DPRK; DZHT;	Në vazhdimësi
	Mungesa e kapaciteteve profesionale të stafit vlerësues të ofertave.	Ligji për Prokurimin Publik	5	6	30	Organizimi i trajnimeve për stafin përkatës në fushën e vlerësimit të ofertave të prokurimit	DZHT	30.09.2026
	Moszbatimi i detyrimeve kontraktuale për shkak të mungesës së kompetencës në menaxhim të kontratave	Ligji për Prokurimin Publik	5	9	45	Organizimi i trajnimeve për stafin përkatës në fushën e menaxhimit të kontratave publike	DZHT	30.09.2026
	Mungesa e efektivitetit të auditimit në detektimin e shkeljeve të integritetit.	Ligji Nr. 08/L-305 për KANS; Rregullore për Menaxhimin e Financave në KANS	4	7	28	Planifikimi i auditimit të përfshijë edhe rreziqet e identifikuar në dokumentin e menaxhimit të rrezikut të KANS.	KDR/Auditimi	Janar 2026
Kontrollit/auditimit dhe mekanizmave kundër korrupsionit								

	Mos identifikimi i konfliktit të interesit nga ana e stafit	Ligji Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik	7	8	56	Hartimi dhe publikimi i rregullores për konflikt të interesit në KANS	KDR	Maj 2026
Siguria e teknologjisë së informacionit	Cenimi i integritetit të të dhënave për shkak të daljes nga rrjeti i ASHI –së (ndërrim statusi).	Ska masë ekzistuese	8	9	72	Përditësimi i Manualit për Menaxhimin e Teknologjisë Informative - Furnizim me pajisje sigurie - Furnizim me softuer për mbrojtjen nga viruset - Trajnim i personelit	Divizioni i Teknologjisë Informative	30.06.2026
Fushat e veçanta të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi i rrezikut			Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve		
			Gjasat	Ndikimi		Njësia/zyrtari përgjegjës		
Ruajtja dhe siguria e të dhënave/ dokumenteve	Mundësi e qasjes së paautorizuar në sistemet/platformat që përdor KANS	Manuali për Menaxhimin e Teknologjisë Informative	4	9	36	Divizioni për Teknologji Informative të sigurohet për parandalimin e qasjes së paautorizuar në sistemet dhe platformat që përdor KANS		
						DTEK/TI		Në vazhdimësi



KANS
KOSOVO • AIR
NAVIGATION
SERVICES

Titulli: PL-INTG-001
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 16 nga 16

që lidhen me sigurinë e ofrimit të shërbimeve	Publikimi i dokumenteve që mund të cenojnë integritetin e raportueseve të ndodhive	Ligji Nr.08/L-175 Për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	5	8	40	KANS të informoj palët që kanë qasje në raportet e ndodhive (MOR), që publikimi i tyre përbën cenim të integritet të institucionit si dhe personelit që ka raportuar ndodhinë.	DCSS	31.10.2026
	Klasifikimi i dokumenteve në KANS	Ligji Nr.08/L-175 Për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	5	7	35	Të rishikohet lista e dokumenteve të klasifikuara	DCSS	31.10.2026

Tabela 3: Lista e rreziqeve